



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës Aziz Thaçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga: <i>PER. BAJRAM GECAS</i>	Shkelqim Jakupi, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 02.06.2017
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Malishevës	Nr. 0-822
Lloji i aktit	Rregullore	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore Nr. 02/175 për punën e kuvendit, komiteteve dhe komisioneve të Komunës së Malishevës
I miratuar më datë: 25.05.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.06.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj, gradonačelnik opštine Mališevo Aziz Thaçi, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a
Od: ZA: BUDRAM BECAJ	Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS Datum: 02.06.2017
Predmet:	Potvrda zakonitosti pravilnik Skupštine opštine Mališevo Br. 0-822
Vrsta akta:	Pravilnik

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Pravilnik br. 02/175 o radu skupštine, odbora i komisija opštine Mališevo
Usvojena dana: 25.05.2017. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 01.06.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



MINISTRIE E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
 REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIC OF KOSOVA

PRANILËNDJE
 ACCEPTED
 PRANILËNDJE
 Nr.No.B: 02/175



**REPUBLIKA E KOSOVËS
 KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË**



**RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT, KOMITETËVE
 DHE KOMISIONEVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA
 DEVELE E ARRIVED PLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data
 Datum: 01.06.2017
 Data

Niveli organizativ	Nr i Libros	Shtesa	Vlera
-4-	0-822		

Malishevë, 2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika b, nenit 40 paragrafi 2 pika a, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, nenit 12, dhe 19 paragrafi 7 shkronja e Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur me datë: 25/05/2017, miraton:

RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT, KOMITETËVE DHE KOMISIONEVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

RREGULLAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore është synuar në arritjen e qëllimeve të jetës pluraliste dhe demokratike në Kuvendin e Komunës së Malishevës.

Neni 2

Duke respektuar të drejtat dhe përgjegjësitë, që dalin me rastin e betimit të bërë nga ana e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Malishevës dhe marrjes së përgjegjësisë, për të dhënë kontributin për një jetë të qetë dhe një prosperitet për të gjithë, me këtë Rregullore do të rregullohet puna e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Neni 3

Kuvendi i Komunës dhe të gjitha Komitetet e tij, do të merren vetëm me ato çështje të cilat janë në kompetencë të tij sipas ligjit në fuqi në Kosovë.

Neni 4

Me këtë Rregullore do të rregullohen të gjitha procedurat në lidhje me punën në Kuvend, por në rast se vjen deri në një konflikt në mes të rregullave të saj dhe rregullave të parapara në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë dhe Statutit të Komunës, do të vlejnjë rregullat e akteve të sipërpërmendura.

Neni 5

Përkufizimet:

Termat dhe përkufizimet në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- a. "Ligjin", Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë Nr.03/L-040
- b. "Statuti i Komunës" nënkupton aktin më të lartë të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës të miratuar në vitin 2008.
- c. "Rregullorja e punës"- është akt që miratohet nga Kuvendi i Komunës që parashikon rregullat e rendit dhe të mirësjelljes.
- d. "Rregullore Komunale" është akt që miratohet nga Kuvendi i Komunës që rregullon një lëmi të caktuar.
- e. "Komunë" do të thotë njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përbërë nga qytetarët e Komuniteteve të një territori të caktuar të përcaktuar me Ligj.
- f. "Kuvendi i Komunës" është organ më i lartë i Komunës vendimmarrës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur nga vota e qytetarëve.
- g. "Kryetari" është organ më i lartë ekzekutiv i Komunës që zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.
- h. "Komitetet" nënkupton Komitetet e përhershme dhe Komitetet e tjera të

- themeluara nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Rregulloren dhe Statutin e Komunës.
- i. "Komision" nënkupton komisionet e rregullta dhe të përkohshme të formuara nga Kuvendi.
 - j. "Anëtar i Kuvendit" nënkupton anëtarin e Kuvendit të zgjedhur drejtpërdrejt nga vota e qytetarit në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale.
 - k. "Kryesues" nënkupton udhëheqësin e Kuvendit të Komunës i cili zgjidhet sipas Statutit të Komunës dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.
 - l. "Këshilli i Drejtorëve" nënkupton drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës të cilët përbëjnë kabinetin e tij.
 - m. "Drejtor" nënkupton të emëruarin politik për mandat të njëjtë me Kryetarin e Komunës i cili drejton një drejtori të caktuar.
 - n. "Mbikëqyrja e ligjshmërisë" do të thotë rishikim i realizuar nga organi mbikëqyrës për tu siguruar se aktet komunale janë nxjerrë në pajtim me dispozitat e zbatueshme ligjore.
 - o. "Votimi i shumicës" do të thotë votim për të cilin kërkohet miratimi i më shumë së gjysmës së anëtarëve të pranishëm dhe votimi në mbledhjen në të cilin shqyrtohet propozimi.

DISPOZITA TË POSAÇME

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal, Komiteteve dhe Komisioneve të këtij Kuvendi.

Neni 6

Selia e Kuvendit Komunal është në rrugën "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" në Malishevë.

Neni 7

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

7.1 Kuvendi i Komunës së Malishevës mban mbledhjet e vota në pajtim me nenin 43, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Malishevës, përkatësisht në mbështetje të nenit 21 par.21.5.

7.2 Kuvendi dhe trupat e tij mund të mbajnë mbledhje edhe jashtë selisë së Kuvendit.

Neni 8

Kryesuesi i Kuvendit duhet të thërret dhe kryesojë mbledhjet e Kuvendit të Komunës, si dhe do të kujdeset për mbarëvajtjen e saj në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Në mungesë të kryesuesit mbledhjen do ta thërret anëtar i më i vjetër i Kuvendit.

Neni 9

Gjithashtu Kryesuesi i Kuvendit, mund të thërras mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, në çdo kohë për shqyrtimin e çështjeve të cilat kërkojnë procedurë të shpejtë shqyrtimi.

Neni 10

Numri i anëtarëve të cilët njëherit përbëjnë kuorumin e Kuvendit të Komunës mund t'i propozojë Kryesuesit të thërret mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.

Neni 11

Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit, kur ai nuk është në gjendje të udhëheqë me Kuvend, 1/3 do ta thërret mbledhjen e rregullt apo të jashtëzakonshme dhe njëherit anëtari më i vjetër që është i pranishëm do ta kryesojë mbledhjen.

Neni 12

Nëse edhe 1/3, nuk është në gjendje të thërras mbledhjen e rregullt apo të jashtëzakonshme, atë mund ta bëjë Kryetari i Komunës, ndërsa anëtari më i vjetër do ta kryesojë atë deri në marrjen e vendimit nga Kuvendi i Komunës në lidhje me këtë çështje.

Neni 13

Mbledhjet e rregullta thirren nga Kryesuesi i Komunës, 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes nga ana e Kuvendit të Komunës, si dhe 3 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së jashtëzakonshme.

Neni 14

Varësisht se kush e thirr mbledhjen e jashtëzakonshme, duhet të arsyetojë se a i plotëson kushtet për të qenë e tillë.

Neni 15

Mbledhja mund të thirret edhe në procedurë urgjente, por gjithashtu ajo duhet të jetë e arsyeshme për tu thirrur si e tillë.

Neni 16

Mbledhjet e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës

Kryesues i Kuvendit njëherit është Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa, është kompetent për t'i thirrur mbledhjet e këtij organi.

Neni 17

Mbledhjet e Komiteteve i thërret Kryesuesi, i cili zgjedhet nga anëtarët e atij komiteti, e në mungesë të tij, do të t'i thërret zëvendësi i tij, por me këtë rast mbledhja duhet të ketë kuorum.

Neni 18

Numri i anëtarëve të ç'do komiteti apo komisioni, që e përbën kuorumin e tij, mund të thërras mbledhjen, urgjente apo të jashtëzakonshme në çdo kohë.

Neni 19

Kuvendi në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisive të veta, në funksion të efikasitetit në lëmi të caktuara për përgatitjen e rekomandimeve, akteve të ndryshme dhe dhënien e propozimeve për çështje konkrete në lëmi përkatëse, përveç trupave të përhershëm obligativ formon edhe trupa të tjerë punuese të përhershme dhe të përkohshme.

Neni 20

Mbledhjet e rregullta të komiteteve dhe komisioneve thirren:

- a). Së paku 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së rregullt,
- b). Së paku 3 ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme

Neni 21

Anëtarët e Kuvendit të Komunës, duhet të njohohen dhe t'i marrin ftesat për:

- a) datën e mbajtjes së mbledhjes
- b) kohën e mbajtjes së mbledhjes
- c) vendin e mbajtjes së mbledhjes
- ç) rendin e ditës dhe
- d) materialet e nevojshme për mbledhje.

Neni 22

Kryesuesi i Kuvendit duhet të garantojë, se kushtet e cekura si në nenin 20 dhe 21, të kësaj Rregulloreje janë plotësuar për zhvillimin e punimeve të Kuvendit përkatësisht të komiteteve dhe komisioneve të tij.

Neni 23

Një kopje e ftesës së cekur duhet të vendoset në tabelën e shpalljeve të KK-së, në mënyrë që publiku të njoftohet në lidhje me mbledhjen e thirrur, si dhe rendin e ditës së kësaj mbledhje.

Neni 24

Pjesëmarrja e publikut në mbledhje

Të drejtë pjesëmarrjeje në mbledhje të Kuvendit të Komunës kanë edhe publiku, në pajtim me nenin 45 par.45.1 si dhe i njëjti mund të përjashtohet nga mbledhja apo nga një pjesë e saj, nëse një takim i tillë mund të shpjerë dhe të shkaktojë çrregullim publik apo dhunë, do të ndikojë në zbulimin e informacioneve të cilat me Ligj janë klasifikuar si të besueshme (Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare) neni 45 par.45.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (Ligji nr.03/L-040. Përjashtimi i publikut duhet të bëhet me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në atë mbledhje.

Neni 25

Kryesuesi i mbledhjes duhet të vendosë për radhën e diskutuesve nga pjesëmarrësit e publikut të cilët mund t'i drejtohen Kuvendit., si dhe t'i ndërpresë ata nëse fjalimi i tyre është i gjatë apo nuk ka të bëjë me kompetencat të cilat me Ligj i janë besuar Komunës.

Debat jashtë rendit të ditës

Neni 26

26.1 Debati jashtë rendit të ditës në çdo mbledhje, para fillimit të rendit të ditës, zgjat 30 minuta.

26.2 Shefat e grupeve të anëtarëve të Kuvendit, kanë të drejtë të marrin fjalën në kohëzgjatje 3 minuta, ndërsa anëtarët e kuvendit në kohëzgjatje 2 minuta.

26.3 Gjatë debatit jashtë rendit të ditës mund ta debatojnë një çështje, ngjarje apo shqetësim.

Neni 27

Procedura e fillimit të punës së mbledhjes së Kuvendit të Komunës

27.1 Rendi i ditës së mbledhjes përgatitet nga Kryesuesi i Kuvendit në konsultim me Kryetarin e Komunës.

27.2 Rendi i punës në mbledhje zakonisht do të ketë këtë formë të përgjithësuar:

- a) Shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

- b) Çfarëdo pike e papërfunduar nga mbledhja e kaluar,
- c) Delegimi dhe pjesëmarrja e publikut ashtu si është cekur në nenin 21, të kësaj Rregullore,
- d) Punët të cilat i ngarkon Ligji, Statuti apo Rregullorja që të kryhen në atë mbledhje,
- e) Çfarëdo çështje e sjellur për debatim, nga Kryetari, Kryesuesi apo grupet parlamentare, apo edhe tema që propozohen aty për aty në mbledhje, si dhe çështje tjera që lindin nga punët dhe detyrat e punës së Kuvendit të kërkuara sipas Ligjit.
- f) Raportet dhe rekomandimet e marra nga Kryetari, Komitetet,
- g) Çështjet që ngritën nga anëtarët e Kuvendit e që janë pranuar për debat nga ana e Kuvendit pas vendimit të marrë me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm,
- h) Pika të ndryshme që sipas mendimit të kryesuesit, meritojnë të shqyrtohen çështje të ndryshme të mbledhjes apo çështje të cilat ndërliken me punën e Kuvendit në përgjithësi.

27.3 Kur ftesat me rendin e ditës iu shpërndahen anëtarëve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi duhet:

- a) Të njoftojë publikun se materiali që iu është shpërndarë anëtarëve të kuvendit mund të kenë qasje edhe ata në pajtim me Ligjin për Qasjen në Dokumentet Zyrtare,
- b) Njofton mediat se mund t'i kenë gjithashtu ato dokumente në pajtim me rregullat e përshkruar në par.23.3 të nenit 23 shkronja (a)

Rregullat e debatimit

Neni 28

28.1 Kryetari i Komunës ka të drejtë t'i drejtohet Kuvendit sipas kërkesës së tij, gjithashtu edhe sa herë që kërkohet nga grupet parlamentare, me kusht që kërkesa të jetë në përputhje me Ligjin. Shefat e grupeve të anëtarëve të Kuvendit kanë të drejtë të marrin fjalën në kohëzgjatje prej 10 minutash, ndërsa çdo anëtar i Kuvendit të Komunës së Malishevës ka të drejtë në debat më së shumti në kohëzgjatje prej 5 minutash. Te gjithë anëtarët pa dallim kanë të drejtë në replikë në kohëzgjatje prej 1 minute.

28.2 Propozimi nuk mund të diskutohet para se i njëjti në mbledhje të shtrohet dhe të përkrahet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

28.3 Kur bëhen ndryshime të pikave të rendit të ditës, propozimi i ndryshuar e zë vendin e propozimit të parë dhe shndërrohet në propozim të rregullt.

28.4 Nëse dy apo më shumë anëtarë dëshirojnë të marrin fjalën, Kryesuesi i mbledhjes vendos për rrjedhën e fjalimeve. Anëtarët që i drejtohen Kryesuesit të mbledhjes edhe gjatë fjalimit të tyre, duhet t'i përmbahen çështjeve të ngritura në rendin e ditës.

28.5 Anëtarët mund të kërkojnë të flasin sipas renditjes ose sipas shpjegimeve personale dhe fjalimi i tij të dëgjohet. Mendimi i Kryesuesit në pikat e renditura ose për pranueshmërinë e shpjegimeve personale është vendimtar.

Iniciativat e grupeve të anëtarëve të Kuvendit

Neni 29

29.1 Iniciativa e grupeve të anëtarëve të Kuvendit nënkuptohet, e drejta e grupit për propozimin e rregullave, për ndryshimin dhe plotësimin e procedurave në lidhje me çështje të cilat nuk janë të paracaktuara me Ligj apo ndonjë akt tjetër nënligjor.

29.2 Iniciativën për të dhënë propozime për plotësime dhe ndryshimeve e kanë edhe Komitetet dhe Komisionet tjera të dalë nga Kuvendi i Komunës.

29.3 Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar nuk lejohet dalja e propozimeve tjera përveç:

- a) Ndryshimeve,
- b) Propozimeve për të parandaluar çrregullimet,
- c) Propozimi për të përjashtuar publikun dhe shtypin, duke u bazuar në nenin 45 par.45.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë.
- d) Propozimin për të kaluar në piken me radhë të Rendit të ditës,
- e) Propozimi që kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit,
- f) Propozimi për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e ardhshme,
- g) Propozimin për ndërprerjen e mbledhjes.

29.4 Kur ndonjë anëtar e ka fjalën në mbledhje, të gjithë anëtarët tjerë pjesëmarrës duhet t'i përmbahen rregullave të mirësjelljes.

29.5 Nëse ndonjë anëtar i Kuvendit të Komunës, jep ndonjë propozim, ai ka të drejtë të kërkojë përgjigje me gojë apo edhe me shkrim, nga Kryesuesi i mbledhjes apo i autorizuari i tij, para se ai propozim t'i nënshtrohet procedurave të votimit.

29.6 Gjatë tërë kohëzgjatjes së mbledhjes Kryesuesi duhet ta respektojë parimin që të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe me të drejtë fjalimi të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje,

29.7 Çdo anëtar ka të drejtë në replikë, por jo edhe në dublikë.

Grupet e anëtarëve të Kuvendit

Neni 30

30.1 Grupet e anëtarëve të Kuvendit përbëhen nga 3 e me shumë anëtarë të Kuvendit.

30.2 Secili anëtar i Kuvendit është i lirë t'i bashkohet ndonjë grupi, të formojë grup apo të jetë i pavarur, por nuk ka të drejtë të formojë grup brenda grupit të anëtarëve të Kuvendit me të njëjtin emërtim.

30.3 Shefin e grupit të anëtarëve të Kuvendit e zgjedhë subjekti dhe përmes një shkrese e njofton Kryesuesin e Kuvendit.

Neni 31

Plani i Punës së Kuvendit;

31.1 Kuvendi i Komunës harton Planin e Punës së tij për vitin e ardhshëm deri më 31 Dhjetor të vitit paraprak.

31.2 Për hartimin e Planit të Punës, Kuvendi formon një komision ad-hoc i cili përbëhet nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend.

Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Neni 32

32.1 Procesverbali është pika e parë e Rendit të ditës në mbledhje, me vendim Kuvendi mundet ta kalojë ndonjë pikë tjetër si të parën në shqyrtim duke e arsyetuar nga ana e Kryesuesit të mbledhjes shkakun e një veprimi të tillë.

32.2 Pas diskutimit nga ana e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, si dhe dhënia e mendimeve dhe vërejtjeve të cilat rekomandohen të jepen me shkrim, por mund të jepet edhe me gojë, procesmbajtësi do t'i përfshijë në procesverbalin e ardhshëm.

32.3 Pas shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve të mundshme nga ana e anëtarëve të Kuvendit, në përfundim të debatit në lidhje me këtë çështje fillon procedura e miratimit të kësaj pike të rendit të ditës.

Procedura e votimit

Neni 33

33.1 Të gjitha vendimet në lidhje me miratimin ose mosmiratimin e pikave të Rendit të ditës merren me votim të hapur, përveç nëse në mbledhje Kuvendi vendos, apo me Ligj parashihet që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë.

33.2 Para votimit secili anëtar ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen ashtu që të bëjë të mundur të shihen votimet e anëtarëve dhe mënyrën se si kanë votuar dhe emrat e atyre që kanë abstenuar.

33.3 Secili anëtar, mund të kërkojë që procesverbali i mbledhjes të shënojë se si ai/ajo ka votuar për çështjen e caktuar, ose nëse ai /ajo ka abstenuar.

33.4 Kur ka nevojë të bëhet votimi mbi propozimin për emërimin ose zgjedhjen e ndonjë anëtari për pozitën e cila duhet mbulohet nga komuna, ose për emërimin e individëve në pozitën e cila ekziston në Shërbimin Civil të Komunës, dhe kur ekzistojnë dy ose më shumë kandidatë të propozuar për pozitën në fjalë, emrat e të gjithë të propozuarve i paraqiten mbledhjes sipas radhës së alfabetit dhe emrit të prindit, dhe mbiemrit të tyre.

33.5 Kur ka nevojë të bëhet votimi i fshehtë, Kryesuesi i mbledhjes merr të gjitha masat për organizimin e një votimi të tillë. Ndërsa kur Kryesuesi mungon masat paraprake i merr Kryetari i Komunës deri në zgjedhjen e kryesuesit, apo anëtari më i vjetër i Kuvendit nëse ka mundësi të kryejë një veprim të tillë. Ai që kryeson këtë procedurë do të formojë komisionin anëtarët e të cilit do t'i përcaktojë Kuvendi.

33.6 Do të shpërndahen të gjithëve anëtarëve të pranishëm fletëvotimet, anëtarët do të renditen sipas alfabetit.

33.7 Kryesuesi i cili udhëheq procedurën duhet të sigurojë edhe kutinë për votime e cila duhet të jetë e gatshme për përdorim në mbledhje në pajtim me kushtet që e kërkojnë procedurat e votimit në përgjithësi. Votimi duhet të bëhet duke zgjedhur përcaktimin e anëtarit të Kuvendit me deklaram, (pro ose kundër ose abstenim)

33.8 Kuvendi duhet të vendosë se cila shenjë apo shkronjë duhet të shënohet afër emrit të kandidatit për të cilin dëshiron të votojë anëtari i kuvendit gjatë procedurave të votimit të fshehtë, si dhe pas vënies së shenjës paracaktuese fletëvotimi hedhet në kutinë për fletëvotime.

33.9 Komisioni të cilin e formon Kuvendi, numëron votat publikisht në mbledhje menjëherë pas mbylljes së votimit dhe deklaron rezultatet pas përfundimit të numërimit të votave. Kryesuesi duhet të garantojë siguri për të gjitha fletëvotimet e dalura në atë votim, si dhe të gjitha procedurat e kryera duhet të evidentohen në procesverbal, dhe të njëjta nuk guxojnë të asgjësohen për së paku 1 vit nga momenti i votimit.

Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit të parashtruara për Kryetarin, Kryesuesin dhe drejtorët komunal

Neni 34

34.1 Anëtarët e Kuvendit të Komunës mund të shtrojnë pyetje për Kryetarin, Kryesuesin apo edhe për drejtorët e drejtorive.

34.2 Pyetjet duhet të bëhen në formën e shkruar dhe e njëjta duhet të marr numrin e protokollit zyrtar, së paku tri ditë para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit.

34.3 Pyetjet me shkrim mund t'i bëhen edhe drejtorëve të drejtorive, mirëpo ata mund t'u përgjigjen vetëm me lejen e Kryetarit të Komunës.

34.4 Përgjigjja mund të jepet edhe në mbledhjen në të cilën parashtrohet pyetja nga ana e anëtarit të Kuvendit, mirëpo nuk është e obligueshme.

34.5 Në mbledhjen e radhës autoritetit të cilit i është parashtruar pyetja me shkrim është i obliguar t'i përgjigjet me gojë ndërsa në raste të caktuara edhe me shkrim, në pikën e ndryshme të rendit të ditës.

Disiplina dhe sjelljet gjatë punës të anëtarit të Kuvendit.

Neni 35

35.1 Nëse Kryesuesi i mbledhjes konsideron se ndonjëri nga anëtarët e Kuvendit nuk sillet korrekt në mbledhje, duke mos i respektuar urdhrat e Kryesuesit dhe duke penguar punën e mbledhjes së Kuvendit me dashje, duke u sjellur në mënyrë ofenduese, Kryesuesi duhet t'i tërheqë vërejtjen personit në fjalë.

35.2 Nëse i njëjti vazhdon edhe përkundër vërejtjes së tërhequr për ndalimin e sjelljes së tillë, Kryesuesi mund të ndërmarrë njëra prej këtyre masave:

- a) I propozon anëtarëve tjerë të Kuvendit që marrin pjesë në mbledhje, që ai të mos dëgjohet,
- b) T'i kërkojë Kuvendit në mbledhje, që të marrë vendim, që atij anëtarit t'i ndalohej fjalimi i mëtutjeshëm në atë mbledhje,
- c) Udhëzon anëtarin që të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votime,
- d) Jep urdhrin që anëtarit të largohet nga mbledhja, përveç kur do të ketë votime,
- e) Të shtyjë mbledhjen për një orë deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet edhe më vonë.
- f) Të kërkojë edhe largimin me dhunë nga punimet e mbledhjes.

35.3 Nëse pjesëtari i publikut me dashje e ndërpre punën e mbledhjes së Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes do t'ia tërheq vërejtjen atij ose asaj. Nëse ai apo ajo, vazhdon të bëjë pengesa për mbarëvajtjen e punimeve të mbledhjes së Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmarrë njëra nga këto masa:

- a) Udhëzon anëtarin e publikut të tërhiqet pjesërisht apo tërësisht nga mbledhja,
- b) Jep urdhrin që anëtarit i publikut të largohet nga punimet e mbledhjes së Kuvendit,
- c) Shtyhen mbledhjen për një orë ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

35.4 Nëse mbledhja e kuvendit, ndërpre punimet për ndonjë çrregullim më të madh, Kryesuesi i mbledhjes mund të urdhërojë që të gjithë të lirojnë Sallën e Mbledhjes së Kuvendit dhe mund ta shtyjë mbledhjen për një orë ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

Kompensimi

Neni 36

36.1 Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, do të kompensohen për punë e tyre në Kuvend dhe Komitetet e tij në pajtim me Ligjin apo akte tjera që e rregullon këtë materie.

36.2 Gjithashtu anëtarët të cilët mungojnë pa arsye nga ndonjëra prej Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës apo në ndonjërin nga komitetet e tij, do të ju hiqen ndalesat në pajtim me Ligjin apo aktet tjera nënligjore që e rregullojnë këtë materie.

36.3 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, duhet të mbahet procesverbali, në të cilin duhet të përshkruhet e gjithë rrjedha e takimit, procedura e votimit, vendimet e marra, ndërsa në fund duhet të nënshkruhet nga Kryesuesi i mbledhjes dhe procesmbajtësi.

Interpretimi

Neni 37

37.1 Vetëm Kuvendi i Komunës së Malishevës, është organ që ka të drejtën e interpretimit autentik të kësaj rregulloreje.

37.2 Në rast se ndonjë nga rregullat e kësaj Rregulloreje, bien ndesh me Ligjin, Aktet nënligjore apo Statutin e Komunës, atëherë vlejnë rregullat e Ligjit, Akteve nënligjore ose të Statutit të Komunës.

Neni 38

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për punën e Kuvendit të Komunës së Malishevës nr.01/312 datë: 06.04.2009.

Hyrja në fuqi

Neni 39

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Datë: 31.05.2017
Nr.02/ 1775

Kryesuesi i Kuvendit

Dr. Aziz Thaci

